



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 30 janar 2023, në mbledhjen e X-të (dhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 13:30.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; dhe Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin drejtorët e Drejtorive, dhe atë; (Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSSH, Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes dhe Mjedisit DPUMM, Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS, Pajtim Balaj-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit)

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit duke i'u dëshiruar mirëseardhje, ndër të tjera theksoi, ashtu siç jeni njoftuar përmes materialit të dërguar përmes e-mailit ne sot në këtë mbledhje kemi 15 pika të rendit të ditës të cilat do t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim.

z.Haki Rudari, theksoi, edhe pse kemi një rend dite me shumë pika, më lejoni që të bëjë një propozim që të hyjë si pikë e rendit të ditës që ka të bëjë me faljen e tatimit në pronë për qytetarët gjerë në vlerë 100€, për vitin 2023, në mënyrë që ky rekomandim t'i kalojë Kuvendit nesër për diskutim, prandaj ky propozim të hedhet në votim.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa i përket propozimit të kolegu z.Haki Rudari, e përshëndes çdo iniciativë që ka të bëjë me lehtësimin e jetës së qytetarëve, gjendja në të cilën gjendemi e krijuar si pasojë e shumë rrethanave, gjegjësisht shtrenjtimi i tatimit në pronë dhe në tokën bujqësore, vërtetë në këtë kohë të inflacionit dhe shtranjtimeve që po ndodhin gjithandej botës e në veçanti këtu tek ne në Kosovë kur dihet se nuk kemi ndonjë bazë ekonomike, vlen të përkrahet ky propozim.

Rreth këtij propozimi desha të jap një mendim sepse qytetari është i ngarkuar me tatimin në pronë në bazë të Ligjit mbi tatimin në pronë dhe dihet se autoritet për miratimin e ligjeve është Kuvendi i Kosovës, ne si Kuvend i Komunës nuk kemi atë të drejtë apo atë kompetencë që të falim borxhe të tatimit në pronë qoftë pjesërisht ose tërësisht, nëse ne nuk kemi të drejtë ligjore t'i falim këto borxhe i bie që ne po i themi qytetarit se po kemi dëshirë të falim borxhin e tatimit në pronë por s'kemi të drejtë ta bëjmë këtë, por nëse veprojmë kështu po më duket sikur jemi duke i vënë në lojë qytetarët në këtë kohë të rënduar ekonomiko-sociale. Unë do e kisha mbështetur plotësisht këtë propozimin që e bëri z.Haki Rudari që Kuvendi i Komunës të dal me një deklaratë në formë të mbështetjes apo sugjerimit për nivelin qendror për faljen e gjithë tatimit në pronë për vitin 2022, kur dihet se në çfarë gjendje kemi kaluar si ekonomi dhe si qytetarë jemi të rënduar ekonomikisht.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa për sqarim ju e cekët vitin 2022, a duhet të jetë viti 2023.

z.Naim Çunaku, theksoi, fjalën e kisha që vlera e pagesës së tatimit në pronë të jetë në gjendjen e vitit 2022.

z.Haki Rudari, theksoi, propozimet të cilat i bëjnë këshilltarët dhe për ato propozime bëhet debat është shkëlqje e Rregullores, çfarë do propozimi që vjen nga LDK-ja, menjëherë të vihet në votim, prandaj përmbajuni Rregullores dhe propozimin tim ta vëni në votim. Sa për sqarim unë nuk thash që të nxirret vendim por e ceka se ne si KPF kemi të drejtë t'i rekomandojmë Kuvendit të njëjtën masë ashtu siç e ka bërë Prishtina sot, prandaj nuk dua të zbuloj diçka por kjo është diçka që është në interes të qytetarëve dhe brenda kompetencave tona si Kuvend, e them edhe njëherë që propozimi im të dal në votim dhe t'i rekomandohet nesër Kuvendit për diskutim, se çka nxjerrë nesër Kuvendi, është nesër pjesë e debatit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, diskutimi i këshilltarit z.Naim Çunaku ishte në frymën e njëjtë, kështu që s'kemi përse të hapim debat, z.Naim Çunaku ishte pro atij propozimi.

z.Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që po del s'kisha dashur të flas për Rregullore se po bëhet e tepërt, Rregullorja lejon debate për pika të rendit të ditës si propozuesit e atyre që i kundërshtojnë dhe i mbështesin ato propozime por nuk dua të ndalem në këtë temë. Qëllimi im ishte se mos po hyjmë në një rrugë që nuk është kompetencë e Kuvendit dhe çdo lehtësim e thash ta pranojmë por nëse kolegu z.Haki Rudari propozon që të falet tatimi në pronë në vlerë 100€, unë kam propozim konkret zotëri Kryesues nëse ka bazë ligjore i rekomandoj dhe propozoj Komitetit për Politikë dhe Financa si pikë të veçantë që të falen të gjitha obligimet tatimore për vitin paraprak, të kthehen në pikën zero ngarkesat e këtyre taksave.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani pa hapur debat e vë në votim propozimin e z.Haki Rudari që të bëhet falja e tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Podujevës në vlerë deri në 100€ për vitin 2023.

Pas votimit, Kryesuesi konstatoi se nga 9 anëtar sa ishin prezent, me 5 vota Për, (të tjerët nuk votuan) mbështetet që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet edhe pika shtesë, dhe atë:

Falja e tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Podujevës në vlerë deri në 100€ për vitin 2023.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani kemi edhe propozimin e z.Naim Çunaku, nga i cili kërkoj që ta bëjë edhe njëherë riformulimin e propozimit të tij.

z.Naim Çunaku, theksoi, si pikë të veçantë të rendit të ditës propozoj që t'i rekomandohet Kuvendit që të shqyrtojë bazën ligjore, gjegjësisht kompetencën e tij që të apeloj, të nxjerrë një deklaratë, nëse ka të drejtën apo atë mundësi ligjore për faljen e tërësishme të borxhit, e jo vetëm 100€, por faljen e tërësishme të borxhit për vitin paraprak duke u nisur nga fakti se kemi një gjendje të rënduar socio ekonomike në vend. Propozimi im është që të bëhet falja e tërësishme e borxhit.

z.Bashkim Sylja, theksoi, unë mendoj se ne si Kuvend nuk kemi bazë ligjore që të falim borxhin në tatimin në pronë por ne mund të nxjerrim një deklaratë si Kuvend dhe t'i propozojmë Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta falë borxhin e tatimit në pronë deri në vlerën 100€, ne këtë deklaratë mund ta bëjmë por të falim borxhe ne nuk kemi të drejtë. Këtu që kemi një keqkuptim sepse kolegu z.Haki Rudari në fillim deshi të bëjë një deklaratë dhe pastaj të diskutohet rreth asaj pike dhe e njëjta pikë t'i rekomandohet Kuvendit që të nxjerrë një deklaratë që të kërkoj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të falë borxhin e tatimin në pronë, kështu unë e kuptova prandaj ne nuk mund të nxjerrim vendime që mund të jenë qesharake dhe të falim tatimin në pronë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka diçka tjetër për të shtuar atëherë na mbetet që ta vë në votim propozimin e z.Naim Çunaku.

z.Naim Çunaku, theksoi, propozimi i kolegut z.Haki Rudari ishte që të falet tatimi në pronë deri në shumën 100€, po të nisemi nga kjo shumë 100€, të gjithë ne jemi në ngjarje se është një temë që ka shqetësuar gjithë opinionin publik dhe vlerësimin në pronë që është bërë, prandaj të mos të bëjmë shaka se

këto tema nuk janë kompetencë tonë, këto i bën dikush tjetër. Propozimi im ishte që të falet borxhi, që ta bëjmë një deklaratë sepse ne nuk mund të falim borxhe prandaj mendoj se ne duhet ta bëjmë një deklaratë që të falen të gjitha borxhet, të mos ketë ngarkesë në tatime dhe pagesa për qytetarin për vitin paraprak duke u bazuar në gjendjen të cilën e kemi kaluar.

z.Haki Rudari, theksoi, këtu kemi një dallim të madh në mes të atyre bizneseve që kanë miliona euro qarkullim sepse nuk mund të krahasohen me ata qytetarë që kanë ngarkesë të tatimit 20€ apo 30 €.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne mund të bëjmë edhe propozime tjera por tani kemi dy propozime të cilat duhet të vihen në votim pastaj t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim, sipas meje më së miri do të ishte që pagesa e tatimit në pronë të kthehej në gjendjen e mëparshme, mirëpo ne nesër këtë çështje do ta diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit, andaj pa humbur kohë më shumë e vë në votim propozimin e z.Naim Çunaku që Kuvendit t'i rekomandohet shqyrtimi i bazës ligjore, gjegjësisht kompetencës së tij që të nxjerrë një deklaratë për faljen e tërësishme të tatimit në pronë duke u nisur nga fakti i gjendjes së rënduar socio ekonomike në vend.

Pas votimit, Kryesuesi konstatoi se me 4 vota Për, 5 vota Kundër, nuk mbështetet propozimi i z.Naim Çunaku që të përfshihet në kundër të rendit të ditës edhe pika që Kuvendit t'i rekomandohet shqyrtimi i bazës ligjore, gjegjësisht kompetencës së tij që të nxjerrë një deklaratë për faljen e tërësishme të tatimit në pronë duke u nisur nga fakti i gjendjes së rënduar socio ekonomike në vend.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, besoj se kjo temë është e duhur për diskutim në Kuvend ku do të kemi mundësi të diskutojmë rreth kësaj temë më gjer e gjatë.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, kisha dashur të bëjë një propozim për seancën e nesërme që të kemi një informatë rreth vërshimeve që ndodhën ditëve të fundit në Komunën e Podujevës, kisha dashur që Drejtoria përkatëse të përgatit një informatë pasi që deri më tani nuk kemi parë asgjë konkrete.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, sa i përket kësaj kërkesë që të përfshihet si pikë e rendit të ditës ju mund ta votoni nëse patjetër mendoni se ky propozim duhet të futet si pikë e rendit të ditës. Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim është përgjegjëse për gjendjen e vërshimeve por ne nuk mundemi me u përgjigj nesër, ju mund ta futni këtë propozim si pikë të rendit të ditës por ne mund të bisedojmë konkretisht për gjendjen se si ka qenë, për masat që i kemi ndërmarr ne si Komunë por për një raport të detajuar nuk mundemi me paraqit nëse e kërkon një të tillë përderisa komisioni për vlerësimin e dëmeve ende është duke bërë vlerësimin e tyre dhe ende jemi duke pranuar kërkesa për vlerësim të dëmeve. Në bazë të pranimit të kërkesave ne i vlerësojmë dëmet përmes komisionit që është i formuar prej 5 anëtarëve, mirëpo raport të detajuar apo të saktësuar nuk mund ta përgatisim si informatë për ditën e nesërme pa e përfunduar punën e tij komisioni sepse kjo detyrë është e komisionit dhe ne pastaj në Kuvend ose përmes e-mailit e juaja mund t'ia dërgojmë materialet zyrtare, si të doni ju vlerësojeni por unë mendoj se për ditën e nesërme ky raport i detajuar nuk mund të përgatitet sepse komisioni për vlerësimin e dëmeve ende nuk ka bërë ende vlerësimin e gjitha dëmeve të shkaktuara si pasojë e vërshimeve në Komunën tonë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, i nderuari këshilltar z.Qëndrim Softolli, a pajtoheni me mendimin e drejtorit z.Bahri Selimi.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, nuk pajtohem në tërësi me këtë mendim, sa i përket vlerësimin të detajuar ose të saktësuar sepse e pash edhe në ueb faqen e Komunës se ende janë duke pritur kërkesat e qytetarëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, një informatë kishte me qenë e domosdoshme jo vetëm për ne por edhe për qytetarët e Komunës së Podujevës, se çka ka ndodh këto ditë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, realisht unë e thash atë se çfarë pata të them, unë po e them se ne mund të diskutojmë rreth kësaj çështje qoftë edhe për gjysmën e kohës së kësaj dite sepse është intervenuar e punuar në shumë vende dhe për të gjitha këto punë të kryera unë mund t'i cek punimet por për dëmet në saktësi pa e përfunduar punën e tij komisioni për të cilën është përgjegjës mbetet informata e përgjysmuar ngase nuk do të ishte informatë e kompletuar, këtë dua ta them unë, përderisa ende vijnë kërkesa nga ana e qytetarëve kurse në anën tjetër tërë ditën komisioni është në terren dhe bën vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet. Komisioni është i ndarë në dy grupe për shkak se gjendja është emergjente prandaj ju veproni si të doni, unë jam në gjendje t'ju përgjigjem por ju vlerësojeni si të doni, votojeni këtë propozim dhe dërgojeni në Kuvend pastaj unë jam i obliguar t'ua sjellë atë informatë nëse ju e votoni si pikë të rendit të ditës por ju them që informatat nuk do të jetë e saktësuar apo e precizuara në tërësi.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, i nderuari Kryesues propozimin tim mund ta vëni në votim pastaj te shohim se si do të vendosim ne.

z.Haki Rudari, theksoi, në parim e përkrahim kërkesën e kolegut por megjithatë meqenëse raporti i dëmeve të shkaktuara ende nuk ka përfunduar mendoj se më e arsyeshme do të ishte që të presim që një informatë të tillë ta kemi në seancën e radhës qoftë ajo seancë e rregullt ose e jashtëzakonshme në mënyrë që ta kemi një informatë të plotë nga ana e Drejtorive apo organeve përgjegjëse. Në parim ne pajtohemi me këtë propozim por ne tani nuk mund të marrim një informatë të plotë pasi që komisionet ende janë në terren prandaj do të ishte mirë që me një konsensus ta kalojmë këtë pikë për seancën e radhës qoftë ajo seancë e rregullt apo e jashtëzakonshme, besoj se Drejtoria është e gatshme për këtë.

z.Naim Çunaku, theksoi, duke marrë parasysh faktin se është bërë më tepër se një javë dhe kemi pas dy herë vërshime radhazi brenda një periudhe një mujore dhe nuk shoh asnjë arsye që Kuvendi të mos debatohet për gjendjen e krijuar si pasojë e vërshimeve, sigurisht ne raport të detajuar për dëmet e shkaktuara si pasojë e vërshimeve mund mos ta kemi, mirëpo të debatohet në Kuvend pas një muaji për gjendjen e shkaktuar si pasojë e vërshimeve, mendoj se këtë e tejkalon koha, andaj e mbështes propozimin e kolegut z.Qëndrim Softolli që nesër në mbledhjen e Kuvendit të debatohet për gjendjen e krijuar si pasojë e vërshimeve në Komunën tonë. Është një gjendje që ka marrë shqetësim gjithandej Republikës së Kosovës dhe fatkeqësisht edhe Komuna e Podujevës është prekur nga vërshimet.

z.Bashkim Sylja, theksoi, nga kolegu ynë z.Qëndrim Softolli kërkoj të kemi një mirëkuptim që propozimin e tij rreth gjendjes së krijuar si pasojë e vërshimeve ta kemi në një seancë të radhës si pikë të rendit të ditës qoftë edhe në një seancë të jashtëzakonshme, pra në momentin që ne e dimë se Drejtoria i përgatit gjitha informatat për gjendjen e shkaktuar nga vërshimet, prandaj është mirë që të marrim një vendim për këtë çështje sepse nuk është hera e parë që Komuna jonë pëson si shkak i vërshimeve, andaj me mirëkuptimin e juaj z.Qëndrim Softolli kërkoj që propozimi i juaj të jetë si pikë e rendit të ditës në një seancë të jashtëzakonshme.

z.Bahri Selimi, theksoi, i nderuari këshilltar z.Qëndrim Softolli ju them se në asnjë mënyrë nuk po mundohem t'i ik asaj që ju po kërkon, binduni sepse ne si Ekzekutiv kemi dashur ta paraqesim një gjendje rreth vërshimeve kurdo që të na jepet mundësia, por tani nëse ne dalim publikisht dhe e bëjmë këtë, kur për dëmet infrastrukurore ne kemi intervenuar dhe jemi duke punuar edhe sot në terren me tri ekipe dhe sipas informacioneve zyrtare të Drejtorisë së paku edhe dy javë kemi punë për sanimin e rasteve emergjente që rrezikojnë të shkaktojnë edhe rreziqe tjera pa e përfshirë këtu edhe ndonjë projekt më të madh për evitimin e tyre në kodin emergjent. Derisa të bëjmë sanimin e gjitha dëmeve të shkaktuara nënkupton se jemi ende në një gjendje emergjente sepse jemi duke punuar me emergjenca dhe tani të dalim pra qytetarëve e të mundohemi t'i cekim gjitha sanimet që i kemi bërë e mos të kemi mundësi që t'i cekim problemet e tyre atëherë do të dalim keq edhe ne si asamble dhe si komunë, prandaj nuk dua t'i japë

mundësi dikujt që të sulmoj në një formë ose tjetër për shkak se nuk e kemi përmendur dëmin e tij ose dëmin e ndonjë fqinji të tij sepse kjo do të krijoj edhe më shumë probleme.

Dëmet e shkaktuara në ekonomitë familjare nuk i dimë të gjitha deri sa ta përfundoj punën e tij komisioni për vlerësimin e tyre, prandaj ju them se ne i dimë më shumë dëmet infrastrukturore dhe ato bujqësore por sa i përket dëmeve në ekonomitë familjare ne ende jemi duke marrë kërkesa nga ana e qytetarëve për vlerësimin e tyre. Raporti më i rëndësishëm është ai dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare sepse së fundi pak i intereson qytetarëve për dëmet e shkaktuara përveç atyre që i ka vërshuar lumi Llap nga gërryerjet në pronat e tyre, këtë mund t'ua them me një shembull se shumë pak mund të ketë interesim për vërshimet në rrugët e fshatit Pakashticë një banor i fshatit Orllan ta zëmë, por i bën përshtypje prona e tij që ju ka dëmtuar, prandaj kjo është arsyeja. Ne së shpejti do të dalim me një informatë këtu para jush, unë jam i obliguar si drejtor i DSHPMShP që gjendjen e shkaktuar nga vërshimet t'ia paraqes në formë të raportit Kryetarit, por një informatë të tillë patjetër edhe Kuvendit do ia paraqes. Në këtë kohë të përgatitet një informatë i bie që ajo informatë është shumë e mangët dhe nuk mund të jemi të saktë dhe kam frikë që do të krijojmë pakënaqësi në mes të qytetarëve e për këtë besoj se edhe ju jeni përgjegjës sepse një pjesë e juaj është dashur më për së afërmi të njihet me problemet e tyre.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë po i qasemi një teme për vërshimet që kanë ndodh në Komunën tonë dhe hiç nuk ka kurrfarë ngjyrimi, mirëpo asgjë s'do të kishte humbur vlerë nëse nesër do të debatim për gjendjen e vërshimeve në Komunën tonë sepse edhe qytetarët do ta shihnin se është preokupim i atyre që i përfaqësojnë për këtë gjendje të krijuar dhe nesër në një deklaratë do ta merrnin qytetarët një premtim nga instancat komunale në Kuvendin e Komunës se për çdo dëm të shkaktuar në fazat e mëtutjeshme do ta bëjmë vlerësimin e tij dhe do t'i përgjigjemi në bazë të mundësive financiare që kemi qoftë nga niveli lokal apo ai qendror. Mendoj se ky do të ishte një veprim i mirë sepse ne dhe qytetarët do të ndiheshim mirë që kemi pas një shqetësim që ka ndodhur dhe ky shqetësim është edhe i yni.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, për një temë kaq të rëndësishme mos të flitet as edhe një fjalë në seancën e Kuvendit nuk besoj që kjo është mirë të kaloj kështu sepse është obligim moral dhe qytetar së paku pa dashur t'ia humb rëndësinë raportit të detajuar sepse atë raport mund ta plotësojmë pastaj, por nuk është efekti i njëjtë nëse ne e mbajmë një seancë në fund të muajit shkurt për vërshimet që kanë ndodh në muajin janar sepse nuk është diçka aktuale, prandaj propozoj që në seancën e nesërme të Kuvendit të Komunës të jetë edhe informata rreth vërshimeve që ndodhen ditëve të fundit në Komunën e Podujevës, prandaj pres që ky propozim të përkrahet nga anëtarët e KPF-së.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush ka për të shtuar diçka urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim propozimin e z.Qëndrim Softolli që të përfshihet në kundër të rendit të ditës edhe pika informatë rreth vërshimeve që ndodhen ditëve të fundit në Komunën e Podujevës.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 4 vota Për, 5 vota Kundër nuk mbështetet propozimi i z.Qëndrim Softolli që të përfshihet në kundër të rendit të ditës edhe pika informatë rreth vërshimeve që ndodhen ditëve të fundit në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, propozimi i z.Qëndrim Softollit nuk kaloi por mbetet që në fillim të muajit shkurt edhe nëse nuk ka mbledhje të rregullt ta mbajmë një mbledhje të jashtëzakonshme dhe të raportohet për gjendjen pas vërshimeve në Komunën tonë.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues, ne kishim një propozim konkret se çfarë do të ndodh në të ardhmen ju nuk jeni ai që do ta përcaktoni atë por kur të vijë e ardhmja do t'i shohim veprimet e juaja, andaj ju them lëreni këtë anë deklarative se ana deklarative nuk ju obligon për këtë çështje.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, ne nga ana e Drejtorisë nuk kërkuam informata të detajuar rreth vërshimeve që ndodhen ditëve të fundit në Komunën e Podujevës, por një informatë të përgjithshme.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, atëherë po mbetet që më së miri do të ishte që një informatë të tillë Drejtoria ta sjellë në muajin gusht.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, nuk keni qenë të interesuar për këtë gjendje të shkaktuar sepse askënd nga ju nuk e kam parë në terren që është interesuar për gjendjen e qytetarëve, kështu që mos e ekzagjeroni këtë çështje më shumë sepse më bëni të dal nga vetvetja, ju s'keni bërë asgjë për këtë çështje edhe pse jeni përfaqësues të qytetarëve ngase me votën e tyre keni ardhur këtu ku jeni sot, dhe asnjë punë se keni bërë për ta edhe pse keni pas mundësi.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, më fal drejtor por ne jemi në një mbledhje zyrtare këtu dhe nuk keni nevojë të më drejtoheni në mënyrë private mua. Ju si Drejtori jeni të thirrur për atë punë dhe jeni të thirrur që të jepni edhe informatë e që të cilës po i ikni dhe s'keni arsye të më akuzoni mua se a kam dal ose jo ta shohë gjendjen e qytetarëve pas vërshimeve, më akuzoni për punën e juaj dhe nuk jepni asnjë informatë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, po jam i thirrur të japë informatë mirëpo arsyen e tregova më herët përse nuk mund të sjellët për nesër.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, nuk është arsye ajo dhe nuk ke nevojë të më akuzosh mua se a kam dalë ose jo për ta parë gjendjen e shkaktuar nga vërshimet, përndryshe ju nam keni bërë, vetëm i keni mbath çizmet e keni dal e ju keni ndihmuar qytetarëve. Është përgjegjësi e juaj të jepni informatë, dhe silleni atë informatë për ato punë që keni bërë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, jo ti e ke bë namin duke shikuar TV, prandaj mos diskuto për këtë çështje. Pra ju keni ndejtë kurse ne për 24 h rresht për dy javë kemi qëndruar në punë.

Pra Hiç s'do të japë informatë. Ne qytetarëve çdo ditë i kemi dhënë informatë, kurse ti vetëm ke shikuar.

Pra leje këtë temë e mos më nxirr nga vetvetja.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, atëherë në rregull, kështu deklarohu para qytetarëve se këtu nuk është pronë private e juaja. Është turp të ketë këso qasje një drejtor.

z.Haki Rudari, theksoi ne në parim e përkrahëm propozimin e juaj se keni të drejtë.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, largojeni këtë qasje, ju jap, s'ju japë informatën për vërshimet në Komunën e Podujevës.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, informatë s'ju japë as juve, sepse qytetarëve jam duke i'u dhënë informatë për çdo ditë sepse është dashur të vraponi edhe ju sikur unë çdo ditë në teren.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, zotëri ju jeni i thirrur për atë punë sepse paguheni për atë punë.

Unë po kërkoj diçka që më takon dhe ju jeni të obliguar ta bëni një informatë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, edhe ju i nderuar paguheni nga qytetarët, për dallim unë jam i emëruar në një pozitë politike, kurse ju jeni i zgjedhur nga një proces zgjedhor. Nëse jam i obliguar atëherë e përgatis informatën por vetëm atëherë kur e kërkon shumica e anëtarëve të KPF-së.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, sipas jush shumica janë vetëm ata që ju kanë votuar kurse të tjerët jo.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ju lutem së pari merreni fjalën për diskutim e mos e zgjatni më shumë këtë debat sepse nuk është në rregull kjo mënyrë e diskutimit.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur ti flet, ai flet, përse s'kam të drejtë të flas unë, ky moralizim i nderuari drejtor, me gjithë respektin për ju, e keni tejkaluar vijën e kuqe, vija e kuqe është e juaja.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, ju them se nuk më bëni të pendohem, flisni gjithë ditën. Mund të flisni edhe dy ditë dhe nuk më bën përshtypje.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju them se kur e bën "Maliqi ligjin" unë e di se çka do të ndodh, e di atë gjë.

Të njëjtën gjë e them edhe unë sepse fjalët e juaja flasin për ty se kush je e nuk flasin për mua, mirëpo të më thotë dikush se duhet Ekzekutivi të mi tregoj detyrat e këshilltarit, kjo nuk është në rregull.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, edhe unë kam qenë këshilltar i Kuvendit Komunal dhe i di detyrat e këshilltarit.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe pse ke qenë këshilltar nuk do të thotë se ka ndryshuar diçka, mirëpo të mi tregoni ju detyrat e mia nuk është në rregull sepse detyrat e mia dhe detyrat e juaja i përcakton ligji.

Në veçanti kjo udhëheqje nga Kryesuesi kalon në faturën e Kryesuesit sepse ky nuk është në gjendje ta menaxhoj një seancë, dhe i lejon të flasin të tjerët duke thënë e lëshova ose jo mikrofonin.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, i nderuari z.Naim Çunaku ju nuk keni të drejtë ta merrni fjalën pa ua dhënë unë.

z.Naim Çunaku, theksoi, kam të drejtë ta marrë fjalën derisa ti flet dhe e ndal mikrofonin dhe flet jashtë temës së rendit të ditës dhe gjuan me fjalë si dhe i ndërprejnë këto fjalë, prandaj nuk mund të ma ndalosh fjalën mua hiç.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë më parë u mundova që ta ndërpresë debatin në mes z.Qendrim Softolli dhe drejtorit të DSHPMSHP z.Bahri Selimi.

z.Naim Çunaku, theksoi, megjithatë po dëshiron të tregohet se kush është më i rëndësishëm dhe nuk i jep llogari askujt, prandaj po them dilni para qytetarëve dhe tregoni këto sepse ju obligon ligji të jepni llogari, e keni ligjin në dorën tuaj vazhdojeni, “Maliqi është ligji” dhe përfundoj debati, por unë jam këtu të flas.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, i nderuari z.Naim Çunaku unë propozimin e z.Qendrim Softolli e hedha në votim, mirëpo ai propozim nuk kaloi dhe këtu nuk kemi asgjë të keqe sepse ju askënd nuk mund ta obligoni që të votoj propozimin e juaj, e tëra ishte kjo.

z.Naim Çunaku, theksoi, asnjë fjalë nuk ishte për votim sepse është e drejtë e secilit të votoj ashtu siç dëshiron vet, por niveli i debatit të drejtpërdrejtë të drejtorit z.Bahri Selimi me z.Qendrim Softolli, ishte jashtë normales.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, gjithë atë debat e nxitët ju z.Naim Çunaku, sepse ju filluat debatin pas votimit të propozimit të z.Qendrim Softolli.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju z.Bahri Selimi në këtë seancë nuk mbani rend, ti je i thirrur si përfaqësues i Ekzekutivit që t’i japësh llogari Kuvendit, nuk mban rend ti këtu, sepse po deklaroheni se fola unë, ai ose ky, kur mora fjalën unë ju e deklaruat se Rregullorja thotë kështu se nuk mund të flitet për rend dite dhe të hapet debat, kurse kur e bëri propozimin z.Qendrim Softolli ju e bëtë të njëjtin veprim, prandaj ju them lëni këto debate.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pa humbur kohë më shumë rreth këtij debati e vë në votim rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përfshirë edhe pikën shtesë të propozuar nga z.Haki Rudari,

Falja e tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Podujevës në vlerë deri në 100€ për vitin 2023.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 5 vota Për, (të tjerët nuk votuan) miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përfshirë edhe pikën shtesë

Falja e tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Podujevës në vlerë deri në 100€ për vitin 2023.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 08.12.2022

z.Naim Çunaku, theksoi, zotëri Kryesues ne detyrohemi ta lëshojmë seancën se nuk kemi ardhur këtu të shtyhemi dhe të tregojmë trimëri sa e shkelim ose jo ligjin, ju vazhdojeni, por edhe këtyre punëve do t’i vije fundi dhe dikush do të ndihet keq për këto gjëra që po ndodhin.

(Nga anëtarët e subjektit politik LDK lëshohet mbledhja sipas arsytimit të cekur nga parafolësi z.Naim Çunaku)

Njëzëri, me 6 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet Procesverbali i KPF-së nga mbledhja e mbajtur më 08.12.2023.

2. Propozim Rregullore për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, thuajse tashmë jeni të informuar për këtë rregullore për transportin e udhëtarëve me automjete taksi, kjo rregullore ka qenë në dëgjim publik dhe tani pritët që ta marr vendimin përfundimtar nga Kuvendi në mënyrë që të fillojmë me zbatimin e saj. Qëllimi i kësaj rregullore është transporti i udhëtarëve me automjete taksi, është për personat fizikë dhe juridik, detajet dhe gjitha procedurat në vazhdim i rregullon gjitha kjo rregullore, prandaj kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të votohet dhe po ta sa ta merr ligjshmërinë nga Ministria të futet në zbatim.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës që të kaloj në Kuvend për diskutim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse ndokush dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Propozim Rregullore për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, edhe kjo rregullore ka të bëjë me transportin rrugor që e rregullon punën e transportit të udhëtarëve me autobusë dhe minibus edhe kjo rregullore ka dal në dëgjim publik me një pjesëmarrje jo aq të kënaqshme por si procedurë ka përfunduar dhe tani është koha që kjo rregullore të votohet në kuvend dhe të filloj zbatimin e saj.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrah dhe e mbështetë këtë propozim këtë pikë të rendit të ditës dhe i rekomandon kuvendit për diskutim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Propozim Vendim për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, ky propozim është një vazhdimësi e rregullores për rregullimin e transportit dhe posa të rregullohet ajo rrjeti i linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit i nevojiten asaj rregulloreje në mënyrë që gjithë operatorët ekonomik që operojnë në Komunën e Podujevës të kenë të caktuar orarin e linjave dhe linjat të cilat ata duhet t'i bartin udhëtarët në mënyrë që banorët e Komunës së Podujevës ta kenë të siguar një transport të udhëtarëve ashtu siç parashihet në këtë rregullore.

z.Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahë këtë propozim vendim ngase përmes këtij propozim vendimi realisht caktohet rrjeti i linjave urbane, urbano-periferike dhe orari i qarkullimit dhe pikat e stacioneve për transportuesit dhe sigurisht se edhe në seancën e Kuvendit ne do ta japim kontributin tonë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

5. Kërkesa – Nisma e procedurës për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunave; Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Obiliq

- Propozim vendim për miratimin e Nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal

- Propozim vendim për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin përkatës të bashkëpunimit ndër-komunal

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, këtu kemi një nismë për bashkëpunim mes Komunave të cekura, kërkesë të cilën e ka proceduar Kryetari i Komunës dhe me kërkesën e tij ka ardhë kjo kërkesë në KPF, nëse dikush nga ju dëshiron fjalën urdhëroni.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë nismë dhe mendojmë se është një nismë shumë frytdhënëse duke marrë parasysh sferat në të cilat pritet të lidhet në kuadër të këtij bashkëpunimi me interes të përbashkët.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

6. Propozim Vendim për shpalljen në interes publik - pronat që preken nga projekti për ndërtimin e rrugës lidhëse nga magjistranja Prishtinë-Podujevë deri te rruga “Vëllezërit Frashëri”.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, në kuadër të rrugëve të reja të planifikuara në kuadër të projekt buxhetit për vitin 2023 planifikohet ndërtimi i rrugës së re lidhëse që është në vazhdimësi prej rr. “Vëllezërit Frashëri”, e cila lidh direkt në magjistralen Prishtinë-Podujevë. Pas përfundimit të përcaktimit të shpronësimit të pronave i rekomandoj KPF-së që ky përopozim vendim të kaloj për rend të ditës në mbledhjen e radhës së Kuvendit për shpalljen në interes publik të kësaj hapësire dhe njëkohësisht fillimi i procedurave për shpronësim si dhe procedurave tjera ligjore të cilat hyjnë në kuadër të këtij projekti.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim që të kaloj në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, duke e ditur rendësin e këtij projekti natyrisht se ne e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

7. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qytetin e Podujevës

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, siç e dimë viteve të kaluara ka filluar projekti për ndërtimin e palestrës së re mirëpo për shkak të problemeve që kanë lindur në atë kohë edhe pse ka një kontratë të nënshkruar është pamundësuar ndërtimi i saj. Një vështirësi tjetër që e kemi sot për ndërtimin e palestrës sportive në atë lokacion, po ky Kuvend me propozimin e Drejtorisë përkatëse ka bërë ndryshim të destinimit të asaj parcele, në vend ku ka qenë e planifikuar ndërtimi i palestrës tani është duke u bërë ndërtimi i Stacionit të Autobusëve dhe rrjedhimisht ne propozojmë sot që propozimi ynë për parcelën që gjendet prapa parkut të pishave t'i kaloj për shqyrtim Kuvendit të Komunës për seancën e nesërme në mënyrë që të merret një vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qytetin e Podujevës për të cilën Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sport me vendim ka planifikuar 1,600,000.00€, për ndërtimin e saj.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qytetin e Podujevës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

8. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike - Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, qëllimi i ndarjes së këtyre mjeteve është gjendja e rëndë ekonomike që ka kjo Ndërmarrje dhe realisht borxhet që i ka ndaj Kompanisë për deponimin e mbeturinave, dhe si pasojë e kësaj të gjitha Komunitat aksionare në këtë Kompani jemi obliguar në takimin e fundit të Bordit të aksionarëve që kishim të marrim një vendim që të ndajmë një lloj subvencionit në mënyrë që kjo Kompani të vazhdoj punën, përndryshe gjendja ekonomike/financiare është mjaftë e keqe në këtë Kompani.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe i rekomandojmë Kuvendit për diskutim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

9. Propozim Vendim për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo – arsimore

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, para vetes keni një propozim vendim për ngritjen e komisionit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore. Këtë e obligon Udhëzimi Administrativ që duhet ta kemi një komision me mandat 1 vjeçar të cilin po e paraqesim para jush.

z.Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së natyrisht se e përkrahim këtë propozim sepse mendojmë se është me rëndësi që të ngritet një komision për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në bazë të Udhëzimeve Administrative të MASHT-it.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

10. Propozim Vendim - për destinimin e paluajtshmëris për ndërtimin e Qendrës Multifunktionale

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, bëhet fjalë për ndërtimin e Qendrës Multifunktionale për të cilën kemi nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi në vitin e kaluar me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Në të kaluarën, lokacioni i planifikuar për këtë projekt ka qenë në parkun e qytetit, mirëpo për shkak se kemi pakë hapësira të gjelbërua në qytet dhe me qëllim që t'i ruajmë ato, kemi vendosur që ta ridestinojmë ndërtimin e saj në hapësirën ku aktualisht ndodhet tregu i gjelbër, pra bëhet fjalë për pjesën e tregut të gjelbër i cili me zhvendosjen e Stacionit të Autobusëve në lokacionin afër qendrës tregtare Park Plaza, krijohet hapësira për tregun e gjelbër dhe në hapësirën e tregut të gjelbër bëhet ndërtimi i Qendrës Multifunktionale. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit është në pritje vetëm që t'i filloj procedurat e prokurimit, prandaj ndërtimi i saj varet prej vendimit që e merr ky Kuvend.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, kërkoj një sqarim nga ana e juaj drejtor, a do të rrenohet objekti i tregut të gjelbër apo do bëhet ndërtimi në pjesën tjetër të tregut ku janë të vendosura tezgat e shitjes.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, tezgat e tregut mund të zhvendosen sepse nuk janë statike prandaj aty do bëhet ndërtimi i Qendrës Multifunktionale, kurse objektet tjera do mbesin ashtu siç janë.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim dhe të njëjtin ia rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

11. Propozim Vendim për vënie në diskutim publik draft Programi Trevjeçar i Banimit 2023-2025

znj. Adelina Stublla, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës fillimisht do të dal në diskutim publik i cili do të zgjatë 30 ditë, kohëzgjatja e diskutimit publik propozoj të jetë nga 06.02.2023 deri më datë 08.03.2023, kurse debati me qytetarë të mbahet më 15.02.2023, ora 10:00, salla e Kuvendit Komunal, ku gjatë kësaj periudhe mund të bëhen të gjitha vërejtjet, sugjerimet apo propozimet eventuale në mënyrë që të bëjmë një bashkëpunim për të mirën e atyre që kanë nevojë për banim.

z. Haki Rudari, theksoi, duke e ditur nga fakti se banimi është një element realisht shumë i ndjeshëm jetësor dhe i garantuar me Ligj dhe Kushtetutë, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe natyrisht se edhe ne do t'i japim idetë dhe propozimet e reja të cilat janë në interes të qytetarëve.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim, duke përfshirë edhe propozimet shtesë të drejtoreshës parafolëse.

Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja e konsultimi publik të jetë nga data 06 shkurt 2023 deri më 08 mars 2023, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 15 shkurt 2023, nga ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

12. Propozim Vendim për vënie në diskutim publik draft Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027

z. Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, në fakt tani ky propozim vendim do të dal në diskutim publik, përkatësisht Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave prandaj vetëm kërkoj që të vihet në diskutim publik. Kohëzgjatja e diskutimit publik propozoj të jetë prej datës 06.02.2023 deri më datë 08.03.2023, kurse më 22.02.2023 debati publik me qytetarë në ora 17:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe të njëjtin ia rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e vë në votim këtë propozim, duke përfshirë edhe propozimet shtesë të paraqitura nga drejtori parafolëse.

Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja e konsultimi publik të jetë nga data 06 shkurt 2023 deri më 08 mars 2023, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 22 shkurt 2023, nga ora 17:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

13. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Barazi Gjinore *(pas dhënies së dorëheqjes së znj.Drita Pajaziti për shkak të emërimit anëtare në Komitetin për Politikë dhe Financa)*

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, kjo pikë tani duhet të kalojë dhe të bëhet plotësimi i përbërjes së Komitetit për Barazi Gjinore pasi që znj.Drita Pajaziti është emëruar anëtare në Komitetin për Politikë dhe Financa, prandaj presim një propozim nga Grupit të këshilltarëve të LVV-së.

z.Haki Rudari, theksoi, ne kemi bërë ndryshim zëvendësimit e këshilltares që ka qenë në këtë Komitet, prandaj propozoj që në vend të ish anëtares znj.Drita Pajaziti në Komitetin për Barazi Gjinore të jetë znj.Lirika Maliqi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim.

Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me propozim që në vend të ish anëtares znj.Drita Pajaziti në Komitetin për Barazi Gjinore të jetë znj.Lirika Maliqi.

14. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij raporti, theksoi, materialin e keni marrë me kohë, ky raport i punës së Kuvendit i takon zyrës së Kryesuesit të Kuvendit dhe ne si zyrë kemi bërë një përshkrim të punëve të realizuara gjatë vitit 2022, të gjitha mbledhjet që janë mbajtur dhe gjitha vendimet, rregulloret dhe aktet tjera që i ka miratuar ky Kuvend janë të paraqitura në këtë raport dhe nëse keni ndonjë vërejtje, sugjerim atëherë urdhëroni.

z.Haki Rudari, theksoi, mendoj se Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, realisht është një formë e mirë e raportimit për arsye se përmes këtij raporti jo vetëm këshilltarët por mediati dhe grupet e ndryshme qoftë OJQ apo të tjera janë të njoftuara për numrin e mbajtjes së seancave, propozim rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme të miratuara në këtë Kuvend, prandaj ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë raport, gjithashtu propozoj që edhe komitetet tjera të përgatisin raporte si ky.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për diskutim të Raportit të punës së Kuvendit të komunës për vitin 2022, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

15. Delegimi i një anëtari të KPF-së në Ekipin për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Podujevës *(Udhëzimi Administrativ (QRK) nr.06/2022 për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës)*

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, delegimi i një anëtari të KPF-së në Ekipin për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Podujevës duhet të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, kështu që ne duhet ta delegojmë një anëtar në këtë Ekip.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, nëse është mundësia që nesër në seancën e Kuvendit ta bëjmë propozimin e një anëtari të Kuvendit në Ekipin për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Podujevës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, një gjë e tillë nuk është e mundur sepse sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) nr.06/2022 për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës një anëtarë duhet të jetë nga radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, propozoj që znj.Drita Pajaziti të jetë e deleguar në përbërjen e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse ndokush dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim që Ky Komitet të nxjerrë një konkluzion me të cilin delegon anëtarin e cekur në përbërjen e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se *Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) me konkluzion mbështetet propozimi për delegimin e znj.Drita Pajaziti në përbërjen e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.*

16. Falja e tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Podujevës, në vlerë deri në 100€ për vitin 2023.

z.Haki Rudari, theksoi, propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj si rekomandim për Kuvendin e Komunës në mënyrë që në seancën e nesërme prapë të debatojmë dhe si Kuvend Komunal kemi të drejtë ta nxjerrim një rekomandim për institucionet e nivelit qendror.

Propozimi im le të rekomandohet nga mbledhja e KPF-së në seancën e radhës së Kuvendit e pastaj nesër në kuadër të debatit të seancës të nxjerrim një rekomandim për institucionet e nivelit qendror.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse ndokush nga anëtarët e Komitetit dëshiron të marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim që ti rekomandohet Kuvendit për përfshirje në rend të ditës si pikë shtesë dhe pastaj për diskutim të kësaj çështje.

Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për diskutim rreth gjetjes së mundësive për faljen e tatimit në pronë në vlerë deri 100€ për qytetarët e Komunës së Podujevës për vitin 2023

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:35

Procesverbalin e mbajtën;

Enis Sheholli

Osman Bajrami

Nr.prot.01-060/04-0008441/23

Podujevë,

30 janar 2023

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha